# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-446031**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Debat për procedurat e tenderave, PS e PD paraqesin kritikat për mënyrën se si zhvillohen garat mes kompanive – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/debat-per-procedurat-e-tenderave-ps-e-pd-paraqesin-kritkat-per-menyren-se-si-zhvillohen-garat-mes-kompanive/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 12:41:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 12:36:33 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d60ad09d8957c77752a9b1aaba52dd432d62d734021aff39b41f6362201fc3c1` |
| TEKSTI | `ee62c601a00ba8f8b881486036668a0ad61398292f2eaff71353fffdbc24ba5b` |
| PAMJA | `741d1d762263f47d653f0752eeb42f365a189cb6bcbdf75737ffdedab5353e2a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `538405c672acffad62c979fb44c98511299b6d6b87b10a16ade86c9fbba2c1de` |
| E MËPARSHMJA | `5c3580787e4bfd7c2a3049ce72a0aab0a9dc5251683cffcfd61963e8b4171313` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/538405c672acffad62c979fb44c98511299b6d6b87b10a16ade86c9fbba2c1de`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Komisioni për Nismat Qytetare u përfshi nga debatet për shkak të mënyrës se si zhvillohen procedurat e tenderave. Garat ku marrin pjesë disa kompani, por që përfundojnë me vetëm një ofertues dhe kontratat e fituara me fond limit, u cilësuan si problematike nga opozita.

*“Shqipëria, i vetmi vend kandidat ku kryeministri merret me tenderët. Kemi raste ku, formalisht, kemi disa ofertues, por ofertuesi i vërtetë është vetëm një. Kjo sepse duket se janë kalkuluar mungesat e dokumentacionit ose mangësitë e ulëta dhe gabimet. Pra, përsëri flamujt e kuq. Përfundojnë me një ofertues të vetëm, që e ka vlerën më të lartë të fondit limit”, tha Ivi Kaso, deputet i Partisë Demokratike.*

Në përgjigje, drejtoresha e Agjencisë së Prokurimit Publik, Reida Kashta u shpreh se ligji aktual i prokurimeve publike është transparent.

*“Procesi është transparent. E përcakton ligji. Nuk ka një shpjegim ligjor për ofertuesit, sepse, në bazë të ligjit të prokurimeve, nuk ka nevojë të kesh shumë oferta për ta mbyllur një procedurë me sukses. Mjafton një ofertë e suksesshme. Ne dalim të vlerësuar për sistemin e prokurimit, shkëlqyeshëm në rajon dhe shumë mirë edhe në raport me vendet e BE-së”, tha Kashta.*

Por edhe socialistët shprehën rezervat e tyre. Kryetari i Komisonit, Fatmir Xhafaj, ngriti shqetësimin se kompani të cilat kanë një sërë problemesh, lejohen të marrin pjesë në gara.

*“Ka subjekte që kanë dështuar në objektiva, por prapë i gjejmë si*

5 Gjykata e Lartë le në burg Erion Veliajn

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

*konkurrues në gara të tjera. Po ndërtove pa leje në Tiranë dhe pastaj merr pjesë sërish në gara për të ndërtuar, ke humbur cilësinë e një operatori serioz në treg", tha Xhafaj.*

Më herët, pjesë e mbledhjes ishte dhe drejtori i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Angelo Koleka, i cili pranoi se ankesat kryesore të qytetarëve lidhen me Kadastrën, gjendjen civile, shëndetësinë dhe bashkitë.

#Debate #komision #PD #PS #Tendera

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh




POLITIKË

**Gjykata e Lartë la në qeli Veliajn, reagon...**

Xhuljana Zhuleku · 25 minuta më parë



POLITIKË

**Rama uron Kurtin për mandatin e ri:...**

Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë



POLITIKË

**Gjykata e Lartë la në burg Veliajn, Ndreca...**

Xhuljana Zhuleku · 3 orë më parë

## Lini një koment

**Komenti juaj** *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

**Emri** *

**E-mail** *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

**Posto komentin**



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.